Ligj për standardin e nxënësve

TEKST I KONSOLIDUAR ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/2005, 117/2008, 17/2011, 135/2011, 15/2013, 41/2014, 146/2015, 30/2016, 64/2018 dhe 20/2019 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 248/2020, 302/2020, 235/2024 dhe 111/2026).

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet themelimi, organizimi, funksionimi dhe administrimi në institucionet për standardin e nxënësve, si pjesë e sistemit të arsimit dhe edukimit.

Neni 2

Standardi i nxënësve realizohet në institucionet publike për standardin e nxënësve, që organizohen si konvikt publik i nxënësve (komunal, përkatësisht konvikti i nxënësve i Qytetit të Shkupit dhe konvikti shtetëror) dhe konvikt privat, si dhe përmes bursimit të nxënësve.

Konviktet për standardin e nxënësve nga paragrafi (1) i këtij neni (në tekstin e mëtejmë konviktet e nxënësve) themelohen për realizimin e interesave dhe nevojave për qëndrimin e nxënësve të cilët mësojnë jashtë vendbanimit.

Veprimtaria e konvikteve për nxënës është me interes publik.

Konviktet e nxënësve kanë cilësinë e personit juridik dhe regjistrohen në regjistrin gjyqësor.

Neni 3

Secili nxënës i rregullt, në kushte të njëjta të përcaktuara me këtë ligj, ka të drejtë të qëndrojë në konviktet e nxënësve.

Neni 4

Veprimtaria edukative-arsimore në konviktin e nxënësve zhvillohet në gjuhën maqedonishte dhe alfabetin cirilik.

Për pjesëtarët e bashkësive, që e ndjekin punën edukative-arsimore në gjuhë që ndryshon nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, e njëjta mbahet në gjuhën dhe alfabetin e bashkësisë përkatëse, në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

Neni 5

Në konviktet nxënësve u ndalohet arsimi fetar, si dhe organizimi dhe veprimi politik dhe fetar.

Në lokalet e konviktit të nxënësve u ndalohet vendosja e shenjave politike dhe fetare.

Neni 6

Konvikti i nxënësve ka vulë.

Në mesin e vulës është stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa anash emri i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe selia e konviktit të nxënësve.

Neni 7

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejmë: Qeveria), në pajtim me dokumentet zhvillimore e planifikon dhe e përcakton zhvillimin e standardit të nxënësve.

Neni 8

Me standardin e nxënësve, në pajtim me këtë ligj, nënkuptohet sigurimi i vendosjes, ushqimit, bursave, si dhe përmbushja e nevojave për punë, kulturore, edukative-arsimore, informative, sportive-rekreative dhe nevojave tjera të përbashkëta të nxënësve.

Standardi i nxënësve është veprimtari e organizuar nëpërmjet të cilës mundësohen dhe realizohen kushtet materiale dhe kushtet tjera për edukim dhe arsimim të nxënësve, bursimi etj.

Neni 9

Konvikti i nxënësve është institucion që u siguron nxënësve vendosje, ushqim, punë edukative-arsimore, përkujdesje për shëndetin, aktivitete kulturore-zbavitëse, sportive-rekreative dhe të tjera.

Konvikt i nxënësve, për nxënësit e arsimit të mesëm, mund të themelohet si subjekt i pavarur juridik ose në përbërje të shkollës së mesme.

Nëse nxënësi mund të vendoset në konviktin e nxënësve, komuna prej ku vjen nxënësi mund të organozojë vendosje në konvikt privat për nxënës ose në familje.

II. THEMELIMI DHE NDËRPRERJA E KONVIKTEVE PËR NXËNËS

Neni 10

Konvikt komunal të nxënësve mund të themelojë komuna.

Vendimin për themelimin e konviktit komunal të nxënësve e merr këshilli komunal pas mendimit paraprak të marrë nga Qeveria.

Konvikt të nxënësve në Qytetin e Shkupit mund të themelojë këshilli i Qytetit të Shkupit.

Vendimin për themelimin e konviktit të nxënësve në Qytetin e Shkupit e merr këshilli i Qytetit të Shkupit, me propozimin e këshillit të komunës në Qytetin e Shkupit, me sigurimin e mendimit paraprak të Qeverisë.

Konvikt shtetëror të nxënësve themelon Qeveria për kategorinë e nxënësve për të cilët ka interes të veçantë.

Konvikt privat të nxënësve mund të themelojë personi fizik dhe juridik i vendit dhe i huaj, në bazë të lejes, në pajtim me këtë ligj.

Neni 11

Kushtet për themelimin e konviktit të nxënësve janë:
- të ekzistojnë nevojat e shtetit;
- të ekzistojnë nevojat e komunës ose të komunave në Qytetin e Shkupit;
- numër i mjaftueshëm i nxënësve sipas normativeve dhe standardeve të përcaktuara;
- të sigurohen mjetet e nevojshme për themelim dhe punë;
- të miratohen plane dhe programe për punën edukative-arsimore dhe punë tjetër me nxënësit;
- të sigurohet pajisja, lokali, kuadri përkatës edukativ; dhe
- kushte të tjera të përcaktuara me këtë ose ligj tjetër.

Kushtet e shënuara në paragrafin 1 në alinetë 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij neni vlejnë edhe për themelimin e konvikteve private për nxënës.

Normat dhe standardet e përcaktuara për numrin e nxënësve nga paragrafi 1 alineja 1 të këtij ligji, si dhe normativet për pajisje, lokal dhe kuadrin edukativ adekuat nga paragrafi 1 alineja 6 nga ky nen, i miraton ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit (në tekstin e mëtejmë: ministri) me propozim të Byrosë për zhvillimin e arsimit (në tekstin e mëtejmë: Byroja).

Neni 12

Lejen nga neni 10, paragrafi 6 i këtij ligji e jep ministria kompetente për kryerjen e punëve nga lëmi i arsimit (në tekstin e mëtejmë: ministria), pas mendimit paraprak nga Inspektorati shtetëror i arsimit, nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 11, paragrafi 1, alinetë 3, 4, 5, 6, dhe 7 të këtij ligji.

Dhënia e lejes bëhet në bazë të kërkesës së paraqitur të personit juridik, përkatësisht fizik (në tekstin e mëtejmë: themeluesi).

Neni 13

Me lejen nga neni 10 paragrafi 6 të këtij ligji ministria përcakton:
- kuadrin e duhur arsimor, pajisjen dhe lokalin sipas standardeve dhe normativave;
- numrin e nxënësve;
- gjuhën në të cilën zhvillohet puna edukative-arsimore;
- programi i veprimtarisë edukative-arsimore, dhe
- fillimi i punës së institucionit privat.

Neni 14

Themeluesi është i detyruar që gjatë themelimit të konviktit për nxënës të formojë komision, që në pajtim me këtë ligj dhe me ligj tjetër bën përgatitje për punën e konviktit.

Neni 15

Konvikti i nxënësve mund të fillojë me punë kur ministria do të marrë vendim për verifikim.

Për kërkesën e parashtruar për verifikim, Ministria miraton aktvendim për verifikim, përkatësisht aktvendim për refuzimin e kërkesës për verifikim në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, në Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe në Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë, në afat prej 15 ditësh prej ditës së pranimit të aktvendimit.

Ministria mban Regjistër qendror të konvikteve për nxënës të themeluara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejmë Regjistri qendror), në përputhje me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

Secila komunë dhe Qyteti i Shkupit për territorin e vet mban Regjistër të konvikteve komunale për nxënës dhe të konvikteve të Qytetit të Shkupit në përputhje me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative dhe për atë dorëzon të dhëna në ministri.

Dispozitat më të përafërta për mënyrën e verifikimit të konviktit për nxënës, si dhe përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit nga paragrafi 3 dhe 4 të këtij neni, i rregullon ministri.

Të dhënat nga regjistrat e komunave dhe Qytetit të Shkupit të cilat dorëzohen në ministri barten në Regjistrin qendror.

Neni 15-a

I fshirë

Neni 16

Ministria, mund ta marrë lejen me propozimin e Inspektoratit shtetëror të arsimit, nëse:
- themeluesi themelon institucion privat në kundërshtim me aktin nga neni 13, nga ky ligj dhe
- konfirmohet se institucioni privat më nuk i plotëson kushtet nga neni 11 paragrafi 1 alinetë 3, 4, 6 dhe 7 të këtij ligji, ose nuk i zbaton dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore që dalin prej tij.

Leja mund të merret edhe me kërkesën e themeluesit.

Neni 17

Me ditën e nxjerrjes së aktit për marrjen, përkatësisht pushimin e lejes, konvikti privat i nxënësve e ndërpret punën.

Në bazë të aktit për marrjen, përkatësisht pushimin e lejes, konvikti privat i nxënësve fshihet nga regjistrat nga neni 15 paragrafi 3 dhe 4 të këtij ligji.

Themeluesi është obliguar që nxënësve të konviktit privat të nxënësve që ka ndërprerë punën, t'u sigurojë vendosje dhe ushqim adekuat me shpenzimet e themeluesit deri në fund të arsimit.

Neni 18

Rrjetin e konvikteve për nxënës e përcakton Qeveria me propozimin e komunave dhe të Qytetit të Shkupit.

Neni 19

Konvikti i nxënësve ndërpret punën nëse nuk zbatohen dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore që dalin prej tij.

Procedurën për ndërprerjen me punë të konviktit shtetëror të nxënësve e inicion dhe udhëheq Ministria, me propozimin e Inspektoratit shtetëror të arsimit.

Procedurën për ndërprerjen me punë të konviktit komunal për nxënës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit, e inicion dhe e udhëheq themeluesi me propozim të Inspektoratit shtetëror të arsimit dhe në pajtim me Ministrinë.

Themeluesi i konviktit për nxënës nxjerr aktin për ndërprerje me punë të konviktit për nxënës dhe ai është i obliguar që nxënësve t'u sigurojë vendosje dhe ushqim adekuat me shpenzimet e themeluesit deri në fund të arsimit.

Konvikti për nxënës, pas nxjerrjes së aktit nga paragrafi 4 i këtij neni, ndërpret me punë dhe fshihet nga regjistrat nga neni 15 paragrafi 3 dhe 4 të këtij ligji.

Akti për ndërprerjen me punë të konviktit për nxënës nga paragrafi 4 i këtij neni shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa për konviktet komunale për nxënës edhe në fletën zyrtare të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit.

Themeluesi pas nxjerrjes së aktit për ndërprerjen me punë të konviktit për nxënës, në afat prej tri ditësh nga dita e marrjes së aktit, e njofton gjykatën regjistruese kompetente për fshirjen e konviktit për nxënës nga regjistri gjyqësor.

III. VEPRIMTARIA EDUKATIVE-ARSIMORE

Neni 20

Puna edukative-arsimore në konviktin për nxënës realizohet sipas planit dhe programit për realizimin e veprimtarisë.

Me planin dhe programin e veprimtarisë edukative-arsimore përcaktohen qëllimet dhe detyrat e punës edukative-arsimore, kushtet pedagogjike, fushat themelore të punës edukative-arsimore në konviktet për nxënës, dhe profili i kuadrit që e realizon programin.

Standardet arsimore me propozim të Byroja për Zhvillimin e Arsimit i miraton ministri.

Neni 21

Planin dhe programin e punës edukative-arsimore përpilohen sipas modelit të programeve të cilin me propozim të Byrosë e miraton ministri. Në modelin përcaktohet edhe fleksibiliteti në realizimin e temave dhe fushave edukativo-arsimore.

Neni 22

Puna edukative-arsimore në konvikte për nxënës realizohet në vite shkollore.

Viti shkollor në konviktin e nxënësve fillon dhe mbaron siç është rregulluar me ligjet përkatëse nga lëmi i arsimit.

Në rast të ndërprerjes së punës edukativo-arsimore, në konviktin e nxënësve sigurohen kushte minimale për punë, të cilat përcaktohen me udhëzim të cilin e miraton ministri.

Neni 23

Në konviktet e nxënësve nuk zhvillohet punë edukative-arsimore gjatë kohës së pushimit të nxënësve dhe në ditën e konviktit si dhe gjatë kohës së festave shtetërore, fetare dhe festat tjera të përcaktuara me ligj.

Më 24 Maj - dita e Shën Kirilit dhe Metodit në konviktet për nxënës organizohen manifestime kulturore, sportive dhe të tjera dhe në atë ditë nuk zhvillohet puna edukative-arsimore.

Pjesëtarët e bashkësive që mbajnë mësimin edukativ-arsimor në gjuhë që ndryshon nga gjuha maqedonishte, e festojnë ditën tradicionale të arsimit të bashkësisë përkatëse, me manifestime kulturore dhe me manifestime tjera.

Neni 24

Veprimtaria edukative-arsimore në konviktet për nxënës organizohet dhe zhvillohet në grupe edukative dhe individuale.

Numri i nxënësve në grupin edukativ në konviktet për nxënës nuk mund të jetë më i vogël se 20 dhe më i madh se 34 nxënës.

Grupi edukativ mund të formohet edhe me numër më të vogël të nxënësve, sipas pëlqimit të marrë paraprakisht nga themeluesi në pajtim me Inspektoratin shtetëror të arsimit.

Numri i nxënësve në grupi edukativ për nxënës me nevoja të veçanta edukative-arsimore është tetë, ndërsa me pengesa të kombinuara deri në gjashtë nxënës.

Grupi edukativ për nxënësit me nevoja të veçanta edukative-arsimore mund të formohet edhe me numër më të vogël respektivisht numër më të madh të nxënësve, sipas pëlqimit të marrë paraprakisht nga themeluesi në pajtim me Inspektoratin shtetëror të arsimit.

Neni 25

Puna në konviktet e nxënësve gjatë vitit shkollor përcaktohet me programin vjetor.

Programin vjetor për punën e konvikteve shtetërore për nxënës e miraton Këshilli drejtues i konviktit, me propozimin e Këshillit të edukatorëve, më së voni deri më 15 shtator të vitit në vijim, ndërsa e miraton Ministria.

Programin vjetor për punën e konvikteve për nxënës, komunale dhe të Qytetit të Shkupit e miraton këshilli komunal dhe i Qytetit të Shkupit, me propozimin e Këshillit drejtues të konviktit për nxënës, më së voni deri 15 shtator të vitit vijues.

Programin vjetor për punën e konvikteve private për nxënës, me propozim të Këshillit të edukatorëve, e miraton organi udhëheqës i konviktit më së voni deri 15 shtator të vitit në vijim, ndërsa e miraton Ministria.

Neni 26

Ministria cakton konviktin publik për nxënës në të cilin bëhet eksperimentim për aplikimin e formave dhe përmbajtjeve të reja të punës edukative-arsimore.

Për zbatimin e praktikës pedagogjike-metodike të studentëve të fakulteteve arsimore, ministria cakton konvikt publik për nxënës.

IV. NXËNËSIT

Neni 27

Regjistrimi dhe pranimi në konviktet komunale dhe në Qytetin e Shkupit bëhet përmes konkursit, të cilin e shpall Ministria në faqen e vet të internetit, më së voni deri më 31 mars, pas propozimeve paraprake të paraqitura nga komunat, dhe nga Qyteti i Shkupit.

Regjistrimi dhe pranimi në konviktet shtetërore bëhet përmes konkursit të cilin e shpall Ministria në faqen e vet të internetit, më së voni deri më 31 mars.

Nxënësi pranohet në konvikt publik të nxënësve nëse është:
- shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- nxënës i rregullt në arsimin e mesëm.

Përparësi për pranim në konvikt publik të nxënësve kanë nxënësit për të cilët në familjen më të ngushtë janë realizuar hyrje të përgjithshme të anëtarëve të familjes jo më të larta se paga minimale e përcaktuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin paraprak.

Kriteret më të përafërta dhe kushtet për pranim, numri i vendeve në disponim, dhe afatet për paraqitje në konkurs për regjistrimin e nxënësve në konviktet për nxënës, përcaktohen me konkurset nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Pranimi i nxënësve në konviktet private për nxënës bëhet përmes konkursit, që e shpall themeluesi.

Nxënësi në konviktin për nxënës parashtron kërkesë për vendosje në konvikt të nxënësve.

Formularin për kërkesën nga paragrafi 7 i këtij neni dhe dokumentacionin e duhur për vendosjen në konvikt të nxënësve i përcakton ministri përgjegjës për punët në fushën e arsimit.

Neni 28

Mënyra dhe procedura për pranimin e nxënësve në konviktet publike të nxënësve përcaktohet me akt të veçantë që e miraton ministri.

Neni 29

Qëndrimi në konviktin për nxënës i ndërpritet nxënësit, nëse:
- e ka mbaruar shkollimin;
- nuk regjistrohet në afatet e caktuara me konkurs;
- çregjistrohet;
- nuk e respekton rendin shtëpiak; dhe
- në raste tjera të përcaktuara me ligjet e arsimit.

Neni 30

Gjatë shfrytëzimit të shërbimeve në konviktet për nxënës, nxënësi është i obliguar t'i kryejë detyrat e përcaktuara me aktet e konviktit për nxënës.

Për cenimin e detyrave dhe mosplotësimin e obligimeve për nxënësin mund të zbatohen masa pedagogjike: vërejtje me shkrim, vërejtje para largimit dhe largim nga institucioni (ndalesë për shfrytëzimin e shërbimeve në institucione).

Largimi nga konviktet për nxënës (ndalesa për shfrytëzimin e shërbimeve në konviktin për nxënës), mund të kumtohet deri në një vit.

Masa e kumtuar edukative ndikon në rendin dhe pranimin e kandidatëve gjatë konkurrimit për pranim në konviktin për nxënës.

Kundër masës së kumtuar edukative, nxënësi ka të drejtë për kundërshtim në afat prej tetë ditësh nga dorëzimi i vendimit, te këshilli drejtues i konviktit për nxënës.

Pas kundërshtimit nga paragrafi 5 të këtij neni, këshilli drejtues i konviktit për nxënës, masën pedagogjike mund ta konfirmojë, ta ndryshojë ose shfuqizojë.

Vendimi ndaj kundërshtimit është përfundimtar.

Neni 31

Mënyra e kumtimit të masave pedagogjike më për së afërmi rregullohet me aktin që e nxjerr ministri.

Neni 32

Ndëshkimi fizik dhe keqtrajtimi psikik i nxënësit ndalohet.

V. EDUKATORËT DHE BASHKËPUNËTORËT NË PUNËN EDUKATIVE-ARSIMORE

Neni 33

Planin dhe programin e punës edukative-arsimore në konviktet për nxënës e realizojnë edukatorët dhe bashkëpunëtorët në punën edukative-arsimore (pedagog, psikolog dhe bibliotekar).

Edukatorët në konviktet për nxënës e kryejnë punën edukative-arsimore me nxënësit dhe i realizojnë qëllimet dhe detyrat e programit.

Bashkëpunëtorët profesionalë në konviktet për nxënës punojnë në punët pedagogjike-psikologjike, bibliotekare dhe punë të tjera profesionale, me të cilat kontribuohet në punën edukative-arsimore.

Edukator në konviktin për nxënës mund të bëhet personi që ka mbaruar studime diplomike përkatëse të arsimit në fakultet, që ka fituar titullin "Bachelor" dhe që ka dhënë provimin profesional.

Edukatorë në konviktet për nxënës mund të jenë edhe personat që kanë mbaruar studime diplomike në fakultet, që ka fituar titullin "Bachelor" dhe që kanë marrë përgatitje pedagogjike-psikologjike e metodike në fakultetet përkatëse dhe që e kanë dhënë provimin profesional.

Edukatorë në konviktet e nxënësve për nxënës nga arsimi i mesëm me nevoja të veçanta edukative-arsimore, mund të bëhen personat me arsim të kryer sipëror nga paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni, e të cilët kanë marrë përgatitje për defektologji, përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike dhe kanë dhënë provimin profesional.

Programet për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike si dhe për përgatitje përkatëse defektologjike-psikologjike e metodike nga paragrafi 6 i këtij neni, i përgatit fakulteti përkatës për arsim në bashkëpunim me Byronë.

Bashkëpunëtor profesional në konviktet për nxënës mund të bëhet personi që ka kryer arsimin përkatës sipëror në pajtim me paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni. Përkatësia e profilit përcaktohet me planet dhe programet për punë edukative-arsimore.

Lloji i arsimit të personave që realizojnë veprimtari edukativo - arsimore përcaktohet me normative për edukatorë në konviktin për nxënës.

Edukatorët nga ky nen duhet të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ta zotërojnë gjuhën letrare dhe alfabetin në të cilën e realizojnë veprimtarinë edukative-arsimore.

Konvikti për nxënës është i obliguar të organizojë kontrollin e edukatorit dhe bashkëpunëtorit profesional për zotërimin e gjuhës nga paragrafi 11 i këtij neni. Kontrollin e bën komisioni të cilin e formon drejtori.

Neni 33-a

Në konviktet e nxënësve vendet e punës së të punësuarve janë:
- nëpunës administrativë,
- dhënës të shërbimeve publike në institucionet e arsimit të lartë dhe
- persona ndihmës teknikë.

Neni 33-b

Të punësuarit në konviktet e nxënësve që kryejnë punë nga natyra administrative kanë status të nëpunësve administrativë.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:
- kategoria V – profesionalë
- niveli V1 këshilltar (këshilltar për punë normative juridike, kontabilist e të tjerë);
- niveli V2 bashkëpunëtor i lartë (bashkëpunëtor i lartë për punë normative-juridike dhe bashkëpunëtor i lartë sekretar-arkëtar dhe të tjerë) dhe

- Kategoria G – ndihmës-profesionalë
- niveli G1 Referent i pavarur (referent i pavarur për punë administrative, për furnizime publike, për punë të kontabilitetit, arkëtar, magazinues dhe të tjerë).

Neni 33-v

Të punësuarit në konviktet e nxënësve që kryejnë punë profesionale kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në konviktet e nxënësve dhe për to zbatohen dispozitat nga ky ligj, dispozitat nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni kategoritë dhe nivelet e vendeve të punës përcaktohen me Ligjin për arsimin fillor dhe Ligjin për arsimin e mesëm.

Neni 33-g

Të punësuarit në konvikte të nxënësve që kryejnë punë ndihmëse teknike kanë status të personave ndihmëteknikë dhe për to zbatohen dispozitat nga ky ligj, Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen këto nëngrupe, kategori dhe nivele të vendeve të punës:
- nëngrupi 1 kategoria A niveli A1 pastrues, ndezës i kazanëve me avull, punëtor për mirëmbajtje të konviktit, kopshtar, haus mjeshtër e të tjerë,
- nëngrupi 2 kategoria A niveli A1 rojtar, portier dhe të tjerë,
- nëngrupi 4 kategoria A niveli A1 kryekuzhinier, kuzhinier, ndihmës kuzhinier-enëlarës, punëtor në kuzhinë e të tjerë dhe
- nëngrupi 5 kategoria A niveli A1 punëtor në depo, korrier dhe të tjerë.

Neni 33-d

Drejtori, me mendim paraprak të Ministrisë së Administratës Publike dhe pëlqim paraprak nga Ministria për Arsim dhe Shkencë miraton plan vjetor për punësim në konviktet e nxënësve për vitin e ardhshëm në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

Neni 34

Zgjedhjen e edukatorëve, bashkëpunëtorëve profesionalë përmes shpalljes publike, e kryen drejtori i konviktit për nxënës, me propozimin e komisionit të konkursit, ndërsa për konviktet private, organi të cilin e autorizon themeluesi.

Shpallja publike për themelimin e vendit të punës shpallet së paku në njëherë në nga gazetat që botohen në gjuhën maqedonishte dhe në gazetat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve, që flasin gjuhë zyrtare që ndryshon nga gjuha maqedonishte.

Gjatë zgjedhjes së edukatorëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe kuadrit tjetër joprofesional në konviktet shtetërore dhe komunale për nxënës, zbatohet parimi i përfaqësimit përkatës dhe i drejtë i qytetarëve që u përkasin të gjitha bashkësive, pa i cenuar kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 35

Edukatorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë në konviktet për nxënës, mund të themelojnë marrëdhënie pune për kohë të caktuar edhe pa shpallje publike, por marrëdhënia e punës të mos zgjasë më shumë se tre muaj gjatë vitit shkollor.

Neni 36

Edukatori dhe bashkëpunëtori profesional në institucion mund të themelojë marrëdhënie pune për kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor, nëse përmes shpalljes publike nuk mund të zgjedhë edukator ose bashkëpunëtor profesional, i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me ligj ose nëse vëllimi i punës zgjat më së shumti se gjysma e kohës së punës në javën e punës të përcaktuar me ligj.

Edukatori dhe bashkëpunëtori profesional mund të themelojë marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar, por më të shkurtër se koha e plotë e punës, nëse vëllimi i punës zgjat së paku sa gjysma e kohës së punës në javën e punës të përcaktuar me ligj.

Neni 37

Të punësuarit në konviktet për nxënës, doemos duhet të kenë kryer kontrollin mjekësor deri në fillimin e vitit shkollor, në çdo tri vjet.

Personit që është i sëmurë nga sëmundje shpirtërore, alkoolizmi dhe narkomania i pushon marrëdhënia e punës në konviktin për nxënës, në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Përcaktimi i aftësive psikofizike të të punësuarve në konviktet për nxënës, përkatësisht lëngimi nga sëmundje të caktuara shpirtërore, alkoolizmi dhe narkomania, bëhet sipas Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

Neni 38

Orari i kohës së punës të edukatorëve dhe bashkë-punëtorëve profesionalë në kuadër të javës së punës prej 40 orësh, përcaktohet me normat që i miraton ministri, sipas ligjit.

Fillimi dhe mbarimi i kohës së punës, shfrytëzimi i pushimit ditor dhe vjetor i edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në konviktet publike për nxënës, përcaktohet me aktin e konviktit.

Neni 39

Edukatori dhe bashkëpunëtori profesional i cili për herë të parë punësohet në konviktin publik të nxënësve, është praktikant.

Stazhi i praktikantit zgjat 1 vit.

Me stazhin e praktikantit edukatori dhe bashkëpunëtori profesional aftësohen për punë të pavarur edukative-arsimore.

Neni 40

Praktikanti në konviktin publik për nxënës e jep provimin profesional.

Provimi profesional jepet sipas programit të përcaktuar para komisionit të formuar nga ministri.

Mënyrën e dhënies së provimit profesional në konviktin publik për nxënës, më për së afërmi e miraton ministri.

Neni 41

Drejtori, edukatori dhe bashkëpunëtori profesional gjatë kohës së punës së tij, është i obliguar që në mënyrë permanente të arrijë përsosje profesionale dhe pedagogjike.

Përsosjen profesionale dhe pedagogjike e organizojnë dhe realizojnë Byroja, fakultetet me grupet e arsimtarëve dhe institucionet e tjera të specializuara publike dhe private.

Format, mënyra, procedura dhe kushtet për përsosje profesionale dhe pedagogjike, përcaktohen me aktin të cilin e miraton ministri.

Neni 42

Në konviktet publike për nxënës për kryerjen e punëve dhe detyrave në mënyrë të pavarur dhe modernizimin e punëve edukative-arsimore, edukatorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë vlerësohen në çdo katër vjet.

Rezultatet nga vlerësimi mundësojnë marrjen e titujve.

Edukatori dhe bashkëpunëtori profesional që është i pakënaqur nga vlerësimi nga paragrafi 1 i këtij neni, ka të drejtë ankese në Ministri.

Kushtet, mënyrën e vlerësimit, vlerësimin e punës, llojin dhe marrjen e titujve, më për së afërmi i miraton ministri.

Neni 43

Për edukatorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë, të cilët në realizimin e procesit edukativ-arsimor nuk tregojnë rezultate të kënaqshme, Byroja, Këshilli i prindërve dhe Inspektorati shtetëror i arsimit, ngrenë iniciativë te këshilli drejtues për rishqyrtimin e aftësisë për realizimin e obligimeve të punës.

Iniciativa nga paragrafi 1 i këtij neni doemos duhet të përmbajë arsyetim për shkaqet për të cilat e njëjta ngritët.

Nëse pranohet iniciativa nga paragrafi 1 i këtij neni, këshilli drejtues i paraqet drejtorit propozim për pushimin e vendit të punës të personave nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 44

Edukatorit dhe bashkëpunëtorit profesional për punën e të cilit nuk ka nevojë për shkaqe ekonomike-teknologjike, strukturore dhe avancimit tjetër, nuk mund t'i pushojë marrëdhënia e punës derisa nuk i sigurohet njëra nga të drejtat sipas ligjit për marrëveshje kolektive.

Mënyra dhe kriteret për shpalljen e tepricës teknologjike përcaktohen me marrëveshje kolektive.

Neni 45

Gjatë ndryshimit të vëllimit të punës në konviktin publik për nxënës që paraqitet për shkak të ndryshimeve në planet dhe programet, organizimin e punës, numrin e grupeve edukative dhe ndryshimeve të tjera, marrëdhënia e punës së edukatorit dhe bashkëpunëtorit profesional, ndërrohet nga marrëdhënia e punës për kohë të pacaktuar me kohën e plotë të punës në marrëdhënie të punës për kohë të pacaktuar me kohë më të shkurtër të punës nga koha e plotë e punës dhe anasjelltas.

Drejtori është i obliguar që në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni me edukatorin dhe bashkëpunëtorin profesional të lidhë kontratë të re pune.

VI. DOKUMENTACIONI DHE EVIDENCA PEDAGOGJIKE

Neni 46

Dokumentacion pedagogjik në pajtim me këtë ligj është libri kryesor i nxënësve.

Libri kryesor i nxënësve është dokument me vlerë të përhershme.

Neni 47

Dokumentacioni pedagogjik në konviktet për nxënës mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonishte me përdorimin e alfabetit cirilik.

Për pjesëtarët e bashkësive të cilët punën edukative-arsimore e zhvillojnë në gjuhë që ndryshon nga gjuha maqedonase, dokumentacioni pedagogjik mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonishte me përdorimin e alfabetit cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin në të cilin zhvillohet puna edukative-arsimore.

Në konviktet për nxënës mbahet evidencë pedagogjike.

Evidenca pedagogjike përfshin: ditarin e punës, ditarin e grupit edukativ, si dhe planifikime të tjera në punën edukative-arsimore.

Ditari i grupit edukativ mbahet në gjuhën dhe alfabetin në të cilin zhvillohet puna edukative-arsimore.

Neni 48

Rregullat më të përafërta për mënyrën, formën dhe përmbajtjen e mbajtjes së dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike në konviktet i miraton ministri.

VII. NORMA DHE ÇMIMI PËR QËNDRIMIN E NXËNËSVE NË KONVIKTET PËR NXËNËS

Neni 49

Çmimi i vendosjes në konviktet për nxënës, respektivisht në familje përcaktohet në bazë shpenzimeve reale sipas normave dhe standardeve për këto lloje të shërbimeve.

Themeluesi i konviktit për nxënës, për nxënësit të cilët mësojnë në shkolla të mesme publike, ndërsa janë të vendosur në konvikt publik për nxënës, respektivisht në familje, merr pjesë më së shumti me 50% nga

çmimi i caktuar nga paragrafi 1 i këtij neni, ndërsa dallimi deri në çmimin e plotë e paguan prindi, respektivisht tutori.

Nëse ministria, komuna respektivisht Qyteti i Shkupit nxënësve të cilët mësojnë në shkolla të mesme publike nuk mund t'u sigurojë vendosje në konvikt publik për nxënës, të njëjtit mund t'i vendosë në konvikt privat për nxënës dhe për ato të marrin pjesë në çmimin për qëndrim me më së paku me 50% nga çmimi i caktuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, ndërsa dallimin deri në çmimin e përgjithshëm e paguan prindi, respektivisht tutori.

Normat dhe standardet nga paragrafi 1 i këtij neni i miraton Ministri, me propozimin e komisionit profesional të formuar nga ministri.

Ministri me akt të posaçëm i rregullon rregullat dhe normat për vendosje në familje nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 50

Lartësinë e çmimit të qëndrimit në konviktet shtetërore për fëmijë e propozon këshilli drejtues, ndërsa e përcakton ministri.

Lartësinë e çmimit të qëndrimit në konviktet komunale për nxënës dhe në Qytetin e Shkupit e propozon këshilli drejtues, ndërsa e verifikon këshilli i komunës respektivisht i Qytetit të Shkupit.

Lartësinë e çmimit të qëndrimit në konviktin privat për nxënës e përcakton organi i caktuar nga themeluesi.

Neni 51

Rregulla më të përafërta për ushqimin e nxënësve në konviktet për nxënës i përcakton ministri në bazë të propozimit të komisionit të formuar nga ministri.

Neni 52

Prindi respektivisht tutori i nxënësit, me konviktin për nxënës lidh marrëveshje për shfrytëzimin e shërbimeve.

Me marrëveshje për shfrytëzim, rregullohen të drejtat dhe obligimet dhe përgjegjësitë e ndërsjella të nxënësve me konviktin e nxënësve.

VIII. BURSIMI I NXËNËSVE

Neni 53

Me qëllim të zbulimit, stimulimit dhe përkujdesin e nxënësve të talentuar në fusha të ndryshme të shkencës, teknikës, kulturës, artit dhe sportit, Ministria do t'u ndajë bursa nxënësve.

Neni 54

Ndarja e bursave për nxënës bëhet në bazë të Konkursit, të cilin e shpall Ministria.

Konkursi nga paragrafi 1 i këtij neni, në varësi nga lloji i bursës i përmban kushtet më të përafërta, numrin dhe lartësinë e bursave, si edhe afatet për ndarjen e bursave.

Në varësi nga lloji i bursës, nxënësi duhet t'i përmbushë kushtet në vijim:
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të jetë nxënës i rregullt në arsimin e mesëm,
- të ketë realizuar sukses në arsim,
- gjendja materiale e familjes më të ngushtë,
- të ketë fituar çmime/diploma në gara shtetërore/ndërkombëtare,
- të ketë provë se është nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe/ose
- të ketë provë se është fëmijë pa prindër.

Për nxënësit romë, Ministria ndan bursa në rast se i përmbushin kushtet nga paragrafi 3 alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Nxënësi parashtron kërkesë në Ministri për fitimin e bursës me dokumentacionin e duhur në shtojcë.

Formularin për kërkesën nga paragrafi 5 i këtij neni dhe dokumentacionin e duhur për ndarjen e bursës i përcakton ministri përgjegjës për punët në fushën e arsimit në pajtim me ministrin e Administratës Publike

Personi i autorizuar zyrtar nga Ministria i cili e udhëheq procedurën është i obliguar që në afat prej tre ditësh prej ditës së pranimit të kërkesës nga paragrafi 5 i këtij neni, me detyrë zyrtare t'i kërkojë provat dhe të dhënat nga paragrafi 3, alinetë 1, 4, 6 dhe 7 të këtij neni.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi publik përgjegjës prej të cilit janë kërkuar provat dhe të dhënat nga paragrafi 3, alinetë 1, 4, 6 dhe 7 të këtij neni është i obliguar që t'i dorëzojë provat dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tre ditësh prej ditës së pranimit të kërkesës.

Personi i autorizuar zyrtar nga paragrafi 7 i këtij neni, në afat prej 60 ditësh prej ditës së pranimit të kërkesës nga paragrafi 5 i këtij neni vendos për kërkesat e parashtruara për ndarjen e bursës."

Paragrafi 3 bëhet paragrafi 10.

Vendimin për numrin e bursave dhe lartësinë e bursave me propozim të ministrisë e merr Qeveria.

Neni 55

Shfrytëzues të bursave për nxënës mund të jenë nxënës të rregullt, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse i plotësojnë kushtet dhe kriteret e caktuara me konkursin.

Neni 56

Ministria mund t'u ndajë bursa shtetasve të huaj në pajtim me vendimin e Qeverisë.

Neni 56-a

Kundër aktvendimeve të Ministrisë për ndarjen e bursave të nxënësve, në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e pranimit te aktvendimit, mund të parashtrohet ankesë në KomisioniN Shtetëror për

Vendimmarrje në Procedurë Administrative, në Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe në Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë.

Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, në Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe në Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë vendos për ankesën e parashtruar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit te ankesës.

Neni 57

Ministria mund të marrë pjesë me mjete në: shoqata, bashkësi, institucione shkencore, shkolla dhe organizata tjera, të cilat krijojnë kushte për zbulimin, stimulimin, zgjerimin dhe thellimin e njohurive të nxënësve nga fusha e shkencës, teknikës, kulturës, artit dhe sportit.

Ministria mund të marrë pjesë me mjete në organizata dhe shoqata profesionale, të cilat do të krijojnë kushte nëpërmjet të programeve të organizuara për prezantim në olimpiada të ndryshme, gara, ekspozita etj që të afirmohen aftësitë dhe talenti i të rinjve.

IX. ADMINISTRIMI DHE UDHËHEQJA NË KONVIKTET PËR NXËNËS

Neni 58

Organ i administrimit në institucionin publik është këshilli drejtues.

Këshilli drejtues në institucionet publike përbëhet prej 7 anëtarëve si vijon: dy përfaqësues nga edukatorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë, një përfaqësues nga prindërit e nxënësve, respektivisht nga tutorët, tre përfaqësues nga themeluesi dhe një përfaqësues nga ministria.

Përfaqësuesit e prindërve respektivisht tutorëve të nxënësve, të themeluesit dhe të ministrisë, nuk mund të emërohen nga radhët e të punësuarve të konviktit publik të nxënësve.

Përfaqësuesit e themeluesit për konviktet shtetërore për nxënës i emëron dhe shkarkon Qeveria, kurse për konviktet komunale dhe të Qytetit të Shkupit, këshilli komunal dhe këshilli i Qytetit të Shkupit.

Përfaqësuesit nga prindërit respektivisht tutorëve të nxënësve i emëron dhe shkarkon këshilli i prindërve, përfaqësuesit nga edukatorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë i emëron dhe shkarkon këshilli i edukatorëve, ndërsa përfaqësuesit nga ministria i emëron dhe shkarkon ministri.

Anëtarët e këshillit drejtues, përveç përfaqësuesit e prindërve, respektivisht tutorëve të nxënësve emërohen për periudhë prej katër vjetësh, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

Përfaqësuesit e prindërve, respektivisht tutorëve të nxënësve emërohen për periudhë deri sa qëndron nxënësi në konviktin për nxënës.

Këshilli drejtues nga radhët e veta e zgjedh kryetarin.

Vendimet e këshillit drejtues miratohen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit.

Neni 59

Këshilli drejtues i konviktit shtetëror për nxënës:
- miraton statutin;
- i propozon programin vjetor të punës dhe raportin e punës Ministrisë;
- i propozon planin vjetor financiar Ministrisë;
- i propozon llogarinë përfundimtare Ministrisë;
- boton shpalljen publike për zgjedhjen e drejtorit;
- bën intervistë me kandidatët për drejtor;
- bën zgjedhjen e drejtorit nga kandidatët e paraqitur në shpalljen e botuar publike për emërimin e drejtorit;
- i paraqet propozim drejtorit për pushimin e marrëdhënies së punës të personave nga neni 43 të këtij ligji;
- vendos për kundërshtimet dhe ankesat e të punësuarve nga konvikti i nxënësve;
- vendos për ankesat e nxënësve, prindërve, përkatësisht kujdestarëve të nxënësve;
- shqyrton edhe çështje tjera të përcaktuara me statutin e konviktit shtetëror për nxënës.

Neni 60

Këshilli drejtues i konviktit komunal për nxënës, respektivisht konviktit për nxënës i Qytetit të Shkupit:
- miraton statutin;
- i propozon programin vjetor të punës dhe paraqet raportin e punës për miratim komunës respektivisht Qytetit të Shkupit;
- i propozon planin vjetor financiar themeluesit;
- i propozon llogarinë përfundimtare themeluesit;
- boton shpalljen publike për zgjedhjen e drejtorit;
- bën intervistë me kandidatët për drejtor;
- nga kandidatët e paraqitur në shpalljen publike të botuar për emërimin e drejtorit, i propozon prefektit të komunës dhe Qytetit të Shkupit një kandidat;
- i paraqet propozim drejtorit për pushimin e marrëdhënies së punës të personave nga neni 43;
- vendos për kundërshtimet dhe ankesat e të punësuarve në konviktin për nxënës;
- vendos për ankesat e nxënësve, prindërve, përkatësisht kujdestarëve të nxënësve;
- shqyrton edhe çështje tjera të përcaktuara me statutin.

Neni 61

Organin e administrimit në konviktin privat dhe kompetencën e tij e cakton themeluesi.

Neni 62

Drejtori është organ udhëheqës i konviktit publik dhe është përgjegjës për ligjshmërinë në punë dhe për punën materiale-financiare të konviktit.

Drejtor i konviktit publik të nxënësve zgjidhet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, i plotëson edhe kushtet për edukator dhe bashkëpunëtor profesional në punën edukative-arsimore, ka arsim sipëror dhe së paku pesë vjet përvojë punë në institucion për punë edukative-arsimore në institucionin e verifikuar nga Ministria dhe provimin e dhënë për drejtor për arsimin fillor dhe të mesëm, në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ttë ketë certifikatë të njohur ndërkombëtarisht ose vërtetim për njohjen e gjuhës angleze edhe atë: TOEFL IBT të paktën 74 pikë, IELTS - të paktën 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal)- së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) – ose BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2, ose posedon certifikatë, dëshmi apo vërtetim me të cilin vërtetohet njohja e një prej tre gjuhëve më të

përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht) në nivelin së paku B2 të Kornizës Evropiane të Referencës për Gjuhët, të lëshuara nga një ent apo institucion në shtet ose jashtë saj, i regjistruar si ofrues i këtij shërbimi, me përjashtim të mësimdhënësve të lëndës së gjuhës angleze, gjuhës frënge dhe gjuhës gjermane.

Me përjashtim, nëse nuk ka kandidat të paraqitur me provim të dhënë për drejtor, për drejtor mund të zgjidhet edhe personi, i cili nuk e ka dhënë provimin për drejtor, por është i detyruar të njëjtin ta jep në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes për drejtor.

Nëse drejtori i zgjedhur nuk e jep provimin për drejtor në afat të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, i pushon mandati i drejtorit.

Mandati i drejtorit të konviktit publik zgjat katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Drejtori i konviktit komunal për nxënës, zgjidhet dhe shkarkohet nga prefekti i komunës, në pajtim me këtë ligj.

Drejtori i konviktit për nxënës i Qytetit të Shkupit, zgjedhet dhe shkarkohet nga prefekti i Qytetit të Shkupit, në pajtim me këtë ligj.

Drejtori i konviktit shtetëror për nxënës, zgjidhet dhe shkarkohet nga këshilli drejtues me pëlqim paraprak të Ministrisë, në pajtim me këtë ligj.

Drejtorin e institucionit privat e emëron dhe shkarkon themeluesi.

Neni 63

Drejtori i konviktit për nxënës e organizon dhe udhëheq punën edukative-arsimore dhe punën tjetër, në mënyrë të pavarur miraton vendime nga fushëveprimi i kompetencës së tij, të përcaktuar me ligjin dhe aktet e konviktit për nxënës dhe e përfaqëson para personave të tretë.

Në realizimin e obligimeve dhe udhëheqjen nga paragrafi 1 të këtij neni drejtori:
- propozon programin vjetor të punës dhe ndërmerr masa për realizimin e tij;
- zbaton vendimet e këshillit drejtues;
- bën zgjedhjen e kuadrit edukativo-arsimor dhe kuadrit tjetër;
- i propozon themeluesit numrin e nxënësve të cilët duhet të qëndrojnë në vitin e ardhshëm shkollor;
- vendos për sistemimin e të punësuarve;
- vendos për pushimin e marrëdhënies së punës së të punësuarve;
- paraqet raportin për suksesin dhe rezultatet e arritura në punën edukative-arsimore përmes standardeve të përcaktuara nga Ministria dhe ia dorëzon këshillit drejtues, Byrosë, Ministrisë, përkatësisht themeluesit në pajtim me programin vjetor;
- kryen edhe detyra tjera të parapara me ligj, statut dhe akte të tjera të konviktit për nxënës.

Drejtori i konviktit shtetëror i paraqet raport për punën materiale-financiare të konviktit për nxënës këshillit drejtues të konviktit shtetëror dhe ministrisë. Drejtori i konviktit për nxënës i komunës, përkatësisht drejtori i konviktit të nxënësve i Qytetit të Shkupit, paraqet raport për punën materiale-financiare të konvikteve të nxënësve deri te këshilli drejtues i konvikteve të nxënësve dhe te këshilli i komunës, përkatësisht te këshilli i qytetit të Shkupit.

Ministri, përkatësisht këshilli i komunës dhe Qytetit të Shkupit, duke pasur parasysh mendimin e këshillit drejtues, e në bazë të raporteve të drejtorëve të konvikteve për nxënës e vlerëson punën e tyre.

Neni 64

Kryetari i komunës, për konviktet komunale për nxënës, respektivisht kryetari i Qytetit të Shkupit, për konviktet e nxënësve në qytetin e Shkupit, tre muaj para skadimit të mandatit të drejtorit aktual, merr vendim që këshilli drejtues të publikojë shpallje publike për zgjedhjen e drejtorit, në së paku tre gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat një nga gazetat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Për konviktet shtetërore, këshilli drejtues tre muaj para skadimit të mandatit të drejtorit aktual merr vendim që të botojë shpallje publike për zgjedhjen e drejtorit në së paku tre gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat një nga gazetat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Në shpalljen e botuar publike përcaktohen kushtet që duhet t'i plotësojë kandidati për drejtor, dokumentacioni i nevojshëm, kohëzgjatja e shpalljes publike dhe afati për të cilin do të bëhet zgjedhja.

Kandidatët e paraqitur ia paraqesin dokumentet e nevojshme sipas shpalljes, këshillit drejtues.

Dokumentet e paraqitura i shqyrton komisioni tre anëtarësh, i zgjedhur nga këshilli drejtues, kompetenca e të cilit përcaktohet me statutin e konviktit.

Komisioni obligohet që në afat prej pesë ditësh pas mbarimit të shpalljes, t'i shqyrtojë dokumentet e paraqitura.

Kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet e parapara me shpallje, u kthehen dokumentet me arsyetim.

Këshilli drejtues mund të kërkojë dokumente plotësuese nga kandidatët që i plotësojnë kushtet, sipas dispozitave të statutit të konviktit për nxënës.

Anëtarët e këshillit drejtues dhe përfaqësuesi i Byrosë, bëjnë intervistë me kandidatët që i plotësojnë kushtet për drejtor.

Këshilli drejtues i konviktit komunal për nxënës, respektivisht i Qytetit të Shkupit në afat prej shtatë ditësh nga biseda e zhvilluar me kandidatët, i propozon prefektit një kandidat për zgjedhjen e drejtorit.

Këshilli drejtues i konviktit shtetëror, në afat prej shtatë ditësh nga biseda e zhvilluar me kandidatët, i propozon ministrit kandidatin për zgjedhje e drejtorit dhe bën zgjedhjen e drejtorit.

Prefekti në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së propozimit, bën zgjedhjen e drejtorit.

Nëse prefekti në afatin e përcaktuar në paragrafin 12 të këtij neni, nuk e emëron drejtorin, është i obliguar që në afat prej tri ditësh ta njoftojë këshillin drejtues me arsyetim më shkrim për shkaqet.

Këshilli drejtues në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi 13 i këtij neni, i paraqet prefektit një propozim për zgjedhjen e drejtorit.

Prefekti është i obliguar që në afat prej pesë ditësh nga dita e marrjes së propozimit, ta zgjedhë kandidatin e propozuar nga këshilli drejtues.

Kandidatët që nuk janë pranuar, në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të vendimit të prefektit, kanë të drejtë ankese ndaj zbatimit të procedurës për zgjedhjen e drejtorit, në KomisioniN Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, në Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe në Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë.

Kundër vendimit të Komisionit, paragrafi 16 të këtij neni, kandidati ka të drejtë ankese te gjykata themelore kompetente.

Neni 65

Drejtori i institucionit publik mund të shkarkohet nga themeluesi:
- me kërkesën e tij;
- në rast se ka bërë cenime gjatë zbatimit të ligjeve, rregullave të tjera dhe akteve të përgjithshme, të përcaktuara nga Inspektorati shtetëror i arsimit;
- nëse nuk e realizon programin e punës dhe nuk realizohen planet dhe programet e punës edukative-arsimore;
- nëse me fajin e tij i është shkaktuar dëm konviktit për nxënës, nxënësve, përkatësisht prindërve ose kujdestarëve të tyre dhe bashkësisë shoqërore;
- nëse lejon organizimin e veprimtarive dhe aktiviteteve që janë në kundërshtim me plan-programet;
- nëse lejon pagesën e mjeteve që nuk janë përcaktuar në planin vjetor financiar të konviktit për nxënës; dhe
- në raste tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 66

Nëse ekzistojnë njohuri të caktuara për veprimet e drejtorit, në kundërshtim me nenin 63 nga ky ligj, këshilli drejtues konvokon mbledhje në të cilën miratohet konkluzion në formë të shkruar i cili i dorëzohet drejtorit.

Drejtori ka të drejtë që në afat prej shtatë ditësh nga pranimi, të prononcohet për përmbajtjen e konkluzionit.

Nëse këshilli drejtues nuk e pranon prononcimin e drejtorit, konvokon mbledhje në afat prej tre ditësh dhe në prani të përfaqësuesit të Inspektoratit shtetëror të arsimit i bën intervistë drejtorit. Përfaqësuesi i Inspektoratit shtetëror të arsimit jep mendim për arsyeshmërinë e shkarkimit të drejtorit.

Nëse këshilli drejtues vlerëson se është e domosdoshme, i paraqet propozim për shkarkimin e drejtorit, prefektit.

Drejtori i shkarkuar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të prefektit, ka të drejtë ankese ndaj zbatimit të procedurës për shkarkim, në KomisioniN Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, në Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe në Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë.

Kundër vendimit të Komisionit, paragrafi 5 i këtij neni, kandidati ka të drejtë ankese në gjykatën themelore kompetente.

Neni 67

Prefekti në afat prej tri ditësh nga dita e shkarkimit të drejtorit, emëron ushtruesin e detyrës drejtor, nga radhët e të punësuarve në konviktin për nxënës i cili i plotëson kushtet për drejtor.

Ushtruesi i detyrës drejtor, i kryen punët deri në emërimin e drejtorit të ri, por jo më shumë se gjashtë muaj nga dita e emërimit të tij.

Neni 68

Personit që është zgjedhur drejtor i konviktit studentor i pezullohet marrëdhënia e punës përderisa ushtron funksionin e drejtorit të konviktit të nxënësve dhe ka të drejtë që, në afat prej pesë ditësh nga dita e ndërprerjes së ushtrimit të funksionit të drejtorit, të kthehet në vendin e punës në konvikt, nëse është emëruar nga radhët e të punësuarve në konvikt, përkatësisht në institucionin ku ka punuar para se të zgjidhej drejtor, në të njëjtin nivel me nivelin në të cilin ka qenë para se të zgjidhej drejtor.

Neni 69

Në konviktet publike për nxënës formohet këshilli i edukatorëve, si organ profesional për realizimin e punës edukative-arsimore.

Këshillin e edukatorëve në konviktet publike për nxënës e përbëjnë edukatorët, bashkëpunëtorët profesionalë dhe drejtori.

Neni 70

Këshilli i edukatorëve:
- shqyrton çështje dhe jep mendim për përmirësimin e jetës dhe punës së konviktit për nxënës;
- jep mendim për propozim-programin vjetor të punës dhe përcjell zbatimin e tij;
- e shqyrton suksesin e nxënësve;
- e konfirmon sjelljen e nxënësve;
- shqyrton realizimin e planit dhe programit dhe ndërmerr masa për zbatimin e tij;
- shqyrton raportin për mbikëqyrjen e kryer profesionale dhe propozon masa;
- zgjedh dhe shkarkon përfaqësues në këshillin drejtues, dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe statutin e konviktit.

Neni 71

Pëlqim për statutin e konviktit komunal, respektivisht konviktit për nxënës të Qytetit të Shkupit jep këshilli i komunës.

Pëlqim për statutin e konviktit shtetëror për nxënës jep ministria.

Neni 72

Në konviktet publike për nxënës formohet këshilli i prindërve të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e prindërve, përkatësisht tutorët e nxënësve.

Këshilli i prindërve i kryen punët si vijon:
- shqyrton çështje dhe jep mendim për përmirësimin e jetës dhe punës së konviktit për fëmijë;
- shqyrton suksesin dhe sjelljen e nxënësve dhe jep mendim për përmirësimin e tij;
- zgjedh dhe shkarkon përfaqësues në këshillin drejtues;
- bashkëpunon me edukatorët, dhe
- kryen punë të tjera me interes për suksesin dhe qëndrimin e nxënësve në konvikt.

Puna, numri i anëtarëve, mënyra e zgjedhjes dhe e organizimit të këshillit të prindërve përcaktohet me statutin e konviktit.

X. FINANCIMI I VEPRIMTARISË NË KONVIKTET PËR NXËNËS

Neni 73

Mjetet për financimin e institucioneve publike sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me Ligjin për buxhetet, Ligjin për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe nga shfrytëzuesit e shërbimeve.

Neni 74

Komuna dhe qyteti i Shkupit mund t'i plotësojnë mjetet të cilat konviktet e nxënësve i marrin nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut me mjete nga burimet e veta, përveç për pagat e të punësuarve në konviktet e nxënësve.

Ministria mund të ndajë mjete për konviktet publike të nxënësve, respektivisht për shkollat e mesme publike në përbërjen e të cilave ka konvikt për nxënës, për shpenzime për punë rrjedhëse lidhur me regjitë për ngrohjen, energjinë elektrike, konsumin e ujit dhe ngjashëm, për nevojat e konviktit të nxënësve, nëse ndodhin situata të paparashikueshme me të cilat rriten shpenzimet, ndërsa nuk kanë mundur të parashikohen dhe të planifikohen në buxhetet e tyre, pas kërkesës së parashtruar me shkrim me arsyetim nga konvikti publik i nxënësve, respektivisht nga shkolla e mesme publike në përbërje të së cilës ka konvikt për nxënës te Ministria dhe me pëlqim paraprak nga Ministria e Financave.

Në kushtet e rrethanave të jashtëzakonshme (konstatim se ekziston gjendje krize, epidemi e shpallur, përkatësisht pandemi, zjarre, vërshime ose fatkeqësi të tjera të mëdha natyrore), Ministria, sipas kërkesës së parashtruar me shkrim me arsyetimin nga konvikti publik i nxënësve, përkatësisht nga shkolla e mesme publike, në përbërje të së cilës ka konvikt të nxënësve, mund të ndajë mjete për konviktet publike të nxënësve, përkatësisht për shkollat e mesme publike, në përbërje të së cilave ka konvikt të nxënësve, për pagesën e rrogave të të punësuarve në to, për periudhën e kohëzgjatjes së rrethanave të jashtëzakonshme.

Mjetet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni ndahen pas vendimit paraprak të miratuar nga Qeveria.

Neni 75

Konviktet për nxënës mund të marrin mjete edhe nga:
- shfrytëzuesit e shërbimeve;
- shitja e prodhimeve dhe shërbimeve si rezultat i punëve të kryera plotësuese, dhe
- legatët, donacionet, pasuritë e lëna me testament dhe burime të tjera.

Mjetet nga paragrafi 1 të këtij neni do të shfrytëzohen në pajtim me planin financiar të konviktit për nxënës.

XI. MBIKËQYRJA

Neni 76

Mbikëqyrjen për ligjshmërinë e punës së konviktit e bën Ministria.

Neni 77

Nëse Ministria do të vlerësojë se statuti ose akti tjetër i konviktit për nxënës nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin, do ta ndalojë zbatimin e aktit deri në marrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 78

Mbikëqyrjen profesionale në konviktet për nxënës e bën Byroja në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Konvikti për nxënës është i obliguar që të mundësojë kryerjen e papenguar të mbikëqyrjes profesionale dhe inspektimit të dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike që mbahet në konvikt.

Neni 79

Për zbatimin e ligjit dhe rregullave të tjera që kanë të bëjnë për standardin e nxënësve, bëhet mbikëqyrje inspektuese.

Mbikëqyrjen inspektuese e bën Inspektorati shtetëror i arsimit dhe inspektorët e autorizuar të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit në mënyrë të përcaktuar me ligj.

Inspektorati shtetëror i arsimit bën edhe mbikëqyrjen e cilësisë së procesit edukativo-arsimor në konviktin për nxënës.

Neni 80

Gjatë mbikëqyrjes së punës të organeve të komunave dhe të Qytetit të Shkupit, Ministria i kryen punët si vijon:
- përcjell ligjshmërinë e punës së organeve të komunës dhe të Qytetit të Shkupit, merr masa dhe aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave të komunës në pajtim me këtë ligj.
- vlerëson se a sigurojnë organet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit që kompetencat e komunave të realizohen sipas standardeve dhe procedurave të përcaktuara me këtë ligj.
- i paralajmëron organet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitë tjetër dhe u propozon masa përkatëse për tejkalimin e situatës së këtillë;
- paralajmëron për mangësi të caktuara materiale dhe procedurale në punën e organeve të komunave dhe të Qytetit të Shkupit, të cilat mund ta pengojnë kryerjen e punëve nga lëmi i standardit të nxënësve me rëndësi lokale.
- jep udhëzime për zbatimin konsekuent të kompetencave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit, në kuadër të këtij ligji me kërkesën e organeve të komunës;

- përcjell nxjerrjen me kohë, të dispozitave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit, të parapara me këtë ligj;
- përcjell ligjshmërinë e vendimeve që i merr prefekti për zgjidhjen e të drejtave individuale, obligimet dhe interesat e personave fizikë dhe juridikë dhe ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj;
- jep mendim dhe ndihmë profesionale sipas propozim-dispozitave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit, të parapara me këtë ligj, me kërkesën e organeve të komunave dhe të Qytetit të Shkupit;
- përcjell realizimin e transparencës në punën e organeve të komunave dhe të Qytetit të Shkupit, në realizimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj, veçanërisht në aspektin e njoftimit të rregullt, me kohë, të vërtetë dhe të plotë të qytetarëve;
- përcjell realizimin e mbikëqyrjes paraprake të dispozitave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit;
- i njofton me kohë organet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit, për gjendjen e konstatuar në punën e tyre dhe për masat e marra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

Neni 81

Nëse edhe pas paralajmërimeve dhe masave e aktiviteteve të marra nga nenin 80 i këtij ligji, organet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit nuk sigurojnë kryerjen e punëve që janë të përcaktuara me ligj si kompetencë e tyre dhe për kryerjen e të cilave mban përgjegjësi komuna edhe Qyteti i Shkupit, me fuqinë e këtij ligji u merret e drejta për ushtrimin e detyrave.

Kryerjen e punëve të marra nga paragrafi 1 i këtij neni, e ndërmerr Ministria, por më së shumti deri në një vit nga dita e ndërmarrjes së tyre.

Ministria, kryerjen e punëve nga kompetenca e komunës dhe Qytetit të Shkupit e bën në emër dhe për llogari të komunës, përkatësisht Qytetit të Shkupit.

Për marrjen dhe ndërmarrjen e punëve nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni ministria i njofton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve të vetadministrimit lokal dhe organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i financave.

Neni 81-a

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i arsimit konstaton se është kryer parregullsi nga neni 82 paragrafët (1) alineja 2 dhe (2) alinetë 6 dhe 9 të këtij ligji, detyrohet që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit apo institucionit ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, i përcakton ministri.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta apo të njëllojta për një ose më shumë persona, përkatësisht për një apo më shumë institucione.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nëse personi ose institucioni për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i arsimit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i arsimit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente.

(9) Inspektorati Shtetëror i Arsimit mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri.

XII. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 82

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje edukatorit ose punëtorit tjetër, nëse:
- e ndëshkon nxënësin fizikisht, përkatësisht e keqtrajton atë psikikisht dhe
- dokumentacionin pedagogjik dhe evidencën e mban në kundërshtim me këtë ligj.

(2) Gjobë në shumë prej 5.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje konviktit të nxënësve, nëse:
- e lejon organizimin dhe veprimin e partive politike dhe organizatave fetare dhe vendosen shenja partiake dhe fetare,
- e fillon kryerjen e veprimtarisë para miratimit të aktvendimit për plotësimin e kushteve për fillimin e punës dhe kryerjen e veprimtarisë,
- shfrytëzon vulë me përmbajtje joadekuate,
- realizon plan-program që nuk është i miratuar nga ministri,
- nuk e realizon numrin vjetor të orëve,
- nuk miraton program vjetor të punës,
- e kryen zgjedhjen e edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj,
- e pengon ose e ndalon inspektorin e arsimit në kryerjen e punëve të inspeksionit të arsimit, nuk ia jep të dhënat e nevojshme dhe nuk i zbaton masat e përcaktuara,
- nuk lidh marrëveshje të re të punës dhe
- e lejon pagesën e mjeteve që nuk janë të përcaktuara në planin vjetor financiar.

(3) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik për kundërvajtjet nga paragrafi (2) i këtij neni do t’i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik.

(4) Gjobë në shumë prej 6.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse themelon institucion privat në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

(5) Gjobë në shumë prej 4.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, nëse themelon institucion privat në kundërshtim me dispozitat nga ky ligj.

Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga Ministria që e udhëheq procedurën, nëse:
- nuk i kërkon provat dhe të dhënat në afat prej tre ditësh prej ditës së pranimit të kërkesës (neni 54, paragrafi 7),
- nuk vendos për kërkesën në afat prej 60 ditësh prej ditës së pranimit të kërkesës (neni 54, paragrafi 9).

Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar prej organit publik përgjegjës prej të cilit janë kërkuar provat dhe të dhënat nëse nuk i dorëzon provat dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tre ditësh prej ditës së pranimit të kërkesës (neni 54, paragrafi 8)

(6) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (4) i këtij neni.

Neni 83

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.

Neni 84

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 82 nga ky ligj, inspektori shtetëror i arsimit është i detyruar kryerësit të kundërvajtjes t'i jep urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, të njëjtën duhet ta nënshkruaj. Pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse nga kryerësi i kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

(3) Në procesverbalin nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet mënyra në të cilën do të hiqen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e bërë.

(4) Kur si kryerës të kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën kundërvajtëse i nënshkruan personi përgjegjës në personin juridik apo personin e autorizuar nga ai.

(5) Inspektori shtetërorë arsimorë është i detyruar të mbajë evidencë për urdhërpagesat kundërvajtëse të lëshuara dhe për rezultatin nga procedurat e ngritura.

(6) Në evidencën nga paragrafi (5) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse e cila i jepet dhe rezultati i procedurës.

(7) Të dhënat personale nga paragrafi (6) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencën.

(8) Ministri i Arsimit dhe Shkencës i përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse.

Neni 84-a

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

XIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 85

Konviktet shtetërore ekzistuese të nxënësve, vazhdojnë me punë si konvikte komunale për nxënës, përkatësisht konvikte për nxënës të Qytetit të Shkupit, në pajtim me dispozitave të këtij ligji prej 1 shtator 2007.

Neni 86

Të drejtat e themelimit dhe obligimet ndaj konvikteve për fëmijë nga neni 85 i këtij ligji i marrin komunat, përkatësisht Qyteti i Shkupit, për konviktet e nxënësve në rajonin e vet prej 1 shtator 2007.

Të drejtën e pronësisë së objekteve dhe pronës së konvikteve për nxënës nga paragrafi 1 i këtij neni, me vendimin e Qeverisë i barten komunës, përkatësisht Qytetit të Shkupit për konviktet e nxënësve të rajonit të vet prej 01.09. 2007.

Neni 87

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, të punësuarit, arkivi, pajisja, dokumentacioni dhe mjetet tjera për kryerjen e punës nga konviktet ekzistuese për nxënës, merren nga konviktet për nxënës të cilët vazhdojnë me punë si konvikte për nxënës të komunës, respektivisht Qytetit të Shkupit, në pajtim me nenin 85 paragrafi 1 i këtij ligji.

Neni 88

Konviktet për nxënës në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do ta harmonizojnë organizimin e tyre, punën, statutin dhe aktet tjera të përgjithshme me dispozita e këtij ligji.

Neni 89

Për edukatorët me përvojë pune mbi dhjetë vjet në shkollat për nxënës me nevoja të veçanta arsimore, të cilët paraprakisht nuk kanë marrë arsimim defektologjik, ndërsa janë hasur në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kanë të bëjnë kushtet e përcaktuara në nenin 33 paragrafi 6 nga ky ligj.

Neni 90

Drejtorët ekzistues të konvikteve janë të detyruar në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të japin provimin për drejtor.

Nëse drejtorët ekzistues nuk e japin provimin për drejtor në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, u pushon mandati për drejtor.

Programin për dhënien e provimit për drejtor, aktin e veçantë për procedurën dhe mënyrën e dhënies së provimit për drejtor, si dhe formën dhe përmbajtjen e vërtetimit të përcaktuar në nenin 62 nga ky ligj, ministri do t'i miratojë në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në marrjen e akreditimit të institucioneve nga neni 62 paragrafi 9 i këtij ligji, përgatitjen e kandidatëve për dhënien e provimit për drejtor do ta bëjnë subjektet e caktuara nga Ministria, të zgjedhur në bazë të shpalljes publike, e në pajtim të Memorandumit të nënshkruar për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencë dhe Unitet States Agecy for International Developoment.

Neni 91

Rregullat më të përafërta të parapara me këtë ligj ministri i miraton në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi.

Neni 92

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji pushojnë të vlejnë dispozitat e Ligjit për standardin e nxënësve dhe studentëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/98 dhe 42/03).

Neni 93

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse nenet 10, 11, 12, 13,14, 15, 18, 19, 25, paragrafi 3, 27, paragrafi 1, 49, 50, 58, 60, 64, 66, 67, 71,73, 74, 79, 80, 81, 88 dhe 89 të këtij ligji do të zbatohen nga 1 shtatori 2005.

DISPOZITA NGA LIGJET PËR NDRYSHIM DHE/OSE PLOTËSIM

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/2011):
Neni 5
Aktet nënligjore të parapara në nenin 81-a, do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 135/2011):
Neni 3
Akti nënligjor nga paragrafi 2 i këtij neni miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi 1 i këtij neni, ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Ministrisë.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 135/2011):
Neni 5
Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitës nga neni 1, paragrafi 3 të këtij ligji, e cila do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):
Neni 4
Drejtorët e konvikteve të nxënësve të zgjedhur deri në ditën e fillimit të zbatimit të neneve 2 dhe 3 të këtij ligji vazhdojnë ta ushtrojnë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin janë të zgjedhur.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

Neni 6

Dispozitat nga neni 1 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14) dhe Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).

Dispozitat nga nenet 2 dhe 3 nga ky ligj, do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave nga neni 2 të këtij ligji që kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj që do të fillojnë të zbatohen pas dy vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 146/2015):

Neni 3

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 146/2015):

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016):

Neni 13

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të nxirren në afat prej 30 ditësh prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 14

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundohen në përputhje me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016):

Neni 15

Dispozitat e neneve 1, 2, 4, 5, 7, 8, 10 dhe 12 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në përputhje me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

Neni 2

Dispozitat nga neni 62 paragrafi 2 të Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 52/2005, 117/2008, 17/11, 135/11, 15/13, 41/14, 146/15 dhe 30/16) dhe dispozitat e nenit 1 të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me kushtin për posedim të certifikatës ndërkombëtarisht të pranuar ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet nuk ka të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

Neni 3
Drejtori i cili është i zgjedhur nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018, është i obliguar ta plotësojë kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes së tij. Drejtorit i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohje të gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

Ligj për plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 248/2020):
Neni 2
Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 302/2020):
Neni 2
Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 235/2024):
Neni 7
Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Ligj për ndryshimin e Ligjit për standardin e nxënësve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 111/2026):
Neni 9
Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".